



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 131 / prot.
11

Tiranë, më 5.2.2026

V E N D I M

Nr. 5, datë 5.2.2026

P Ë R

**PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË, TË CILËT KANË
KALUAR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS NGA
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Pas verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe pas miratimit të listës së kandidatëve magjistratë që pranohen në Shkollën e Magjistraturës në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në zbatim të nenit 248, 266 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" të nenit 53 të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", nenit 32, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", vendimit nr. 43, datë 3.2.2026, "Për kualifikimin e kandidatit z. **D K** për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2025-2026" të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 5.2.2026,

V E N D O S I:

1. Të publikojë listën e kandidatëve për gjyqtar 2025-2026, të cilët kanë kaluar me sukses procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas listës bashkëngjitur pjesë e pandarë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES**

**LISTA E KANDIDATËVE PËR GJYQтар
NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR
NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS
PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026,
MIRATUAR NGA KLGJ-JA, PAS VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS**

Nr.	Emër Mbiemër	Profili	Data e miratimit
1.	D K	Kandidat për gjyqtar	3.2.2026